



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .02.2022

MBLEDHJA Nr. 05,
datë 04.02.2022, ora 09:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 04.02.2022, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 05 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 26.01.2022
2. Mbi depozitimin nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) për miratim në ERE të kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë dhe kriterëve për përzgjedhjen e tij
3. Mbi transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k, nr. 49, seria NPM07P dhënë me vendimin e bordit nr. 61, datë 02.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar
4. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.04.2021, mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW”
5. Mbi ecurinë e zbatimit të objektivave strategjike të ERE-s, për periudhën 2021 e në vijim, sipas planit të masave për zbatimin e objektivave strategjike të ERE-s, për periudhën 2021 – 2023 si dhe miratimin e planit të masave për objektivat strategjike të ERE-s, të rishikuar për vitin 2022 – 2023
6. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe

zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI